



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4055 Prot.

Tiranë, më 27.06. 2023

URDHËR

Nr. 322, Datë 27.06.2023

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL
“UDHËRRËFYES TURISTIK PËR RAJONIN E JUGUT”, NË UNIVERSITETIN
“ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 72, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Udhërrëfyes Turistik për Rajonin e Jugut”, me 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik (2 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet certifikatë profesionale në “Udhërrëfyes Turistik për Rajonin e Jugut”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin Ismail Qemali Vlorë, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional, në “Udhërrëfyes Turistik për Rajonin e Jugut”, në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së certifikatës profesionale së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI



Konceptoi: K. Mjaltaj

Pranoi: A.Gjini

Miratoi: B. Biçoku

V.Koçi

Konfirmoi: E. Tola